



## **Kërkesë për oferta - Shërbimet e webmasterit të projektit**

### **Titulli i projektit: “Empowerment to youth and vulnerable groups with the counselling process using ProfilPASS Instrument and Social Coaching”**

Nga hulumtimi i tregut për kompanitë potenciale në Kosovë, ftojmë kompanitë që të bëjnë ofertë për shërbimet e mëposhtme.

Kompanitë që janë të interesuara ju lutemi të plotësoni dokumentin e mëposhtëm dhe të mos përdorni modele të tjera.

Ofertat duhet të dorëzohen me email; kopje të pastra të skanuara.

Kompania që do të fitojë kontratën do të duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme;

- Certifikatë regjistrimi
- Detajet bankare/pasqyra nga banka -
- Profili i kompanisë dhe referencat

Thirrja do të jetë e hapur nga data: 09/12/2024 deri më datë: 15/12/2024 në ora: 16:00.

Ofertat dorëzohen në email: [oferta.eycd@gmail.com](mailto:oferta.eycd@gmail.com)

Autoriteti kontraktues:

Environment & Youth Capacity Development

Afërdita Shala, Kordinatore e projektit

Adresa:Ruga "William Walker",Prizren-Kosovë

Tel: +383 44 816-504

[ngo.eycd@gmail.com](mailto:ngo.eycd@gmail.com), <https://eycd.net/>



## SHTOJCA I: TERMAT E REFERENCAVE

### SHËRBIMET E WEBMASTER

Autoriteti kontraktues: Mjedisi dhe Zhvillimi i Kapaciteteve Rinore

Adresa: Rruga “William Walker”, Prizren – Kosovë, Tel: +383 44 816-

504 ngo.eycd@gmail.com, <https://eycd.net/>

Emri i projektit: Empowerment to youth and vulnerable groups with the counselling process using ProfilPASS Instrument and Social Coaching



1. INFORMACIONI BAZË.....	4
1.1. Autoriteti Kontraktor .....	4
2. OBJEKTIVI, QËLLIMI & REZULTATET E PRITSHME .....	4
2.1. Objektivi i përgjithshëm.....	4
3. SUPOZIMET DHE RREZIQET.....	4
3.1. Supozimet në bazë të ndërhyrjes së projektit.....	4
4. FUSHA E PUNËS .....	5
4.1. Të përgjithshme .....	5
4.1.1. Përshkrimi i detyrës .....	5
4.1.2. Aktivitete specifike.....	5
4.2. Menaxhimi i projektit .....	6
5. LOGJISTIKA DHE KOHA .....	6
5.1. Data e fillimit & Periudha e zbatimit të detyrave për Lotin 1 dhe 2.....	6
5.2. Koha e reagimit të mobilizimit .....	6
6. KËRKESAT.....	7
6.1. Personeli.....	7
6.2. Akomodimi në zyrë: .....	8
6.3. Lehtësirat që do të ofrohen nga kontraktori:.....	8
6.4. Pajisjet.....	8
6.5. Sigurimi: .....	8
7. KËRKESAT E RAPORTIMIT DHE FATURIMI .....	8
7.1. Bugjeti:.....	10



## 1. INFORMACIONI BAZË

### 1.1. Autoriteti Kontraktor

OJQ “Mjedisi dhe Zhvillimi i Kapaciteteve Rinore”

## 2. OBJEKTIVI, QËLLIMI & REZULTATET E PRITSHME

### 2.1. Objektivi i përgjithshëm

#### **Objektivi i Përgjithshëm i Kontratës**

Objektivi i përgjithshëm i kësaj kontrate është angazhimi i një webmasteri profesional për të zhvilluar dhe mirëmbajtur databaza dhe faqe interneti të projektit, në përputhje me Termat e Referencës (ToR). Kjo përfshin zhvillimin e databazave të ProfilPASS-it në tre gjuhë dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të faqes së internetit të projektit, duke siguruar funksionalitet të plotë, përmirësime teknike, siguri dhe qasje të përmirësuar për përdoruesit.

#### **Lot 1: Zhvillimi i Databazave ProfilPASS / 3 versione në 3 gjuhë**

Të sigurohen shërbime profesionale për zhvillimin e databazave të ProfilPASS-it, të përshtatura për tre gjuhë (shqip, serbisht dhe anglisht). Kjo përfshin krijimin dhe optimizimin e strukturave të databazës, sigurinë e të dhënave dhe përputhshmërinë teknike, në pajtim me Termat e Referencës për këtë shërbim. Këto databaza do të përdoren për të ndihmuar përdoruesit të identifikojnë dhe menaxhojnë aftësitë dhe kompetencat e tyre në mënyrë efektive.

#### **Lot 2: Mirëmbajtja e Faqes së Internetit dhe Databazave / Faqja e internetit e projektit**

Të sigurohen shërbime profesionale për mirëmbajtjen e vazhdueshme të faqes së internetit të projektit dhe databazave përkatëse. Kjo përfshin migrimin e përmbajtjes ekzistuese, zhvillimin e elementëve të rinj, përmirësimet vizuale dhe teknike, si dhe zbatimin e masave të sigurisë. Gjithashtu, shërbimet përfshijnë monitorimin dhe përditësimin e faqes për të siguruar funksionim optimal, duke u bazuar në Termat e Referencës për këtë lot.

## 3. SUPOZIMET DHE RREZIQET

### 3.1. Supozimet në bazë të ndërhyrjes së projektit



N/A

## 4. FUSHA E PUNËS

### 4.1. Të përgjithshme

#### 4.1.1. Përshkrimi i detyrës

#### **Lot 1: Zhvillimi i Databazave ProfilPASS / 3 versione në 3 gjuhë**

Ky lot ka për qëllim zhvillimin dhe implementimin e tre databazave të dedikuara për ProfilPASS-in, të disponueshme në tre gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Detyrat përfshijnë krijimin e strukturave teknike për ruajtjen dhe menaxhimin e informacionit, duke siguruar që databazat të jenë funksionale, të optimizuara dhe në përputhje me standardet teknike. Gjithashtu, do të kryhet testimi dhe sigurimi i qëndrueshmërisë teknike për të mundësuar një përdorim të lehtë dhe të sigurt nga përdoruesit.

#### **Lot 2: Mirëmbajtja e Faqes së Internetit dhe Databazave / Faqja e Internetit e Projektit**

Ky lot fokusohet në sigurimin e funksionimit, përmirësimit dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme të faqes së internetit të projektit dhe databazave të lidhura. Kjo përfshin migrimin e përmbajtjes ekzistuese në sistemin e ri, krijimin e përmbajtjes së re për të përmbushur objektivat e projektit, dhe mirëmbajtjen teknike për të garantuar performancë të lartë dhe funksionalitet të pandërprerë. Përgjegjësitë gjithashtu përfshijnë përmirësime të dizajnit grafik, rezervimin e rregullt të të dhënave, zbatimin e masave të sigurisë për mbrojtjen nga hakerimet dhe analizimin e statistikave për të optimizuar performancën e faqes.

#### 4.1.2 Aktivitete specifike

#### **Lot 1: Zhvillimi i Databazave ProfilPASS / 3 versione në 3 gjuhë**

- Zhvillimi i tre databazave:
  - Një për ProfilPASS keshillime per te rritur.
  - Një për ProfilPASS keshillime per stratup biznese
  - Një për ProfilPASS keshillime per grate
- Krijimi i përmbajtjes cilësore dhe të lokalizuar në tre gjuhë (shqip, serbisht, anglisht), duke përfshirë përshkrime dhe elemente vizuale që reflektojnë kërkesat e ProfilPASS.
- Testimi i plotë i databazave dhe përmbajtjes së integruar për të siguruar funksionalitet dhe qëndrueshmëri.

#### **Lot 2: Mirëmbajtja e Faqes së Internetit dhe Databazave / Faqja e Internetit e Projektit**



- Migrimi i përmbajtjes së faqes ekzistuese në sistemin e ri dhe testimi i funksionalitetit pas migrimit.
- Monitorimi dhe mirëmbajtja teknike e faqes, duke përfshirë azhurnimet e sistemit, shtojcat dhe elementët funksionalë.
- Zbatimi i detyrave të dizajnit grafik, përfshirë krijimin dhe optimizimin e elementeve vizuale për faqen e internetit.
- Sigurimi i rezervimeve ditore për të parandaluar humbjen e të dhënave dhe garantimin e rikuperimit të tyre.
- Zbatimi i masave të avancuara të sigurisë për të parandaluar sulmet kibernetike dhe për të garantuar funksionalitet të pandërprerë.
- Mbledhja dhe raportimi periodik i statistikave për performancën dhe sjelljen e përdoruesve për faqen e internetit.

#### 4.2. Menaxhimi i projektit

Menaxhimi i projektit do të merret nga kordinatori i projektit ose zëvendësi i tij/saj i deleguar.

## 5. LOGJISTIKA DHE KOHA

### 5.1. Data e fillimit & Periudha e zbatimit të detyrave për Lotin 1 dhe 2

Data e fillimit të zbatimit të të dy loteve do të jetë data e nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët. Periudha e zbatimit të detyrave të përcaktuara është tetë muaj nga data e fillimit. Kjo përfshin të gjitha aktivitetet dhe përgjegjësitë përkatëse për realizimin me sukses të objektivave të kontratës.

### 5.2 Koha e reagimit të mobilizimit

#### **Loti 1: Zhvillimi i ProfilPASS Databazave**

Ekipi i projektit do të dorëzojë Urdhëresën e Shërbimit tek kontraktori, i cili duhet të fillojë zbatimin në kohë reale të shërbimeve të kërkuara. Në raste të veçanta urgjente/ad hoc, siç është nevoja për të adresuar çështje kritike në funksionalitetin e databazave të zhvilluara, kontraktori duhet të veprojë menjëherë dhe të ndërlidhet me koordinatorin/en e projektit dhe ekipin teknik, në koordinim të ngushtë me menaxherin e projektit.



## **Loti 2: Mirëmbajtja e Faqes së Internetit dhe Databazave**

Ekipi i projektit do të dorëzojë Urdhëresën e Shërbimit tek kontraktori, i cili duhet të reagojë në kohë reale për çdo shërbim të kërkuar. Në raste urgjente/ad hoc, siç është një sulm kibernetik apo një çështje e papritur me funksionalitetin e faqes së internetit, kontraktori duhet të veprojë menjëherë dhe të ndërlidhet me koordinatorin/en e projektit, ofruesin e domenit dhe ekipin përgjegjës, në koordinim të ngushtë me menaxherin e projektit.

### **6. KËRKESAT**

#### **6.1. Personeli**

Kontraktuesi duhet të caktojë një menaxher të kontratës i cili është pika kryesore e kontaktit për Autoritetin Kontraktor.

Menaxheri i kontratës duhet të jetë përgjegjës për marrjen e Urdhrit të Shërbimit dhe sigurimin e ekzekutimit të Urdhrit të Shërbimit brenda afatit të paraparë siç është specifikuar në 5.2. Ky person është gjithashtu përgjegjës për dorëzimin e raportit të shërbimit tek Autoriteti Kontraktor.

Menaxheri i kontratës duhet të dorëzojë një CV ku do të theksojë arsimimin dhe përvojën e tij në këtë fushë.

CV-ja e menaxherit të propozuar të kontratës duhet të dorëzohet si pjesë e dokumentacionit të dosjes së tenderit pasi do të shërbejë si bazë për vlerësimin teknik.

Menaxheri i kontratës duhet të përmbushë kërkesat minimale të mëposhtme:

- Minimumi arsimor është Diplomë Universitare në Teknologji Informativë, Shkenca Kompjuterike ose disiplina të ngjashme;
- Së paku tre vjet përvojë pune progresive në zhvillimin e burimeve të ueb-it: dizajnim ueb, programim, përmbajtje.
- Përvojë në marketing në internet: optimizimi i kërkimit, promovimi i faqeve të internetit, promovimi i kryqëzuar dhe ndërlidhja, etj.
- Njohuri mbi Sistemet e Menaxhimit të Përmbajtjes (CMS).
- Të kuptuarit se si funksionojnë protokollet e uebit, duke përfshirë HTTP, HTTPS, SSL, SSH dhe FTP.



- Përvoja në përdorimin e mjeteve të tilla si Macromedia, Flash, etj. Përvoja e softuerit të redaktimit të videove do të jetë një avantazh.
- Njohuri të Google Analytics dhe mjeteve të tjera të statistikave në ueb.
- Një kombinim i aftësive të shkëlqyera të zgjidhjes së problemeve, komunikimit dhe ndërpersonale
- Aftësi për të punuar në një mjedis me ritme të shpejta dhe me shumë detyra.
- Njohuri të mira të gjuhës angleze

#### 6.2. Akomodimi në zyrë:

N/A

#### 6.3. Lehtësirat që do të ofrohen nga kontraktori:

N/A

#### 6.4. Pajisjet

Asnjë pajisje nuk duhet të blihet në emër të Autoritetit Kontraktor si pjesë e kësaj kontrate shërbimi ose t'i transferohet Autoritetit Kontraktues në fund të kësaj kontrate.

#### 6.5. Sigurimi:

N/A

## 7. KËRKESAT E RAPORTIMIT DHE FATURIMI

### Loti 1: Zhvillimi i ProfilPASS Databazave

- Monitoroni dhe vlerësoni përdorshmërinë dhe performancën e databazave të krijuara për arkivimin e përmbajtjes dhe ruajtjen e statistikave;
- Gjurmoni proceset e zhvillimit të databazave, duke siguruar që të përmbushen afatet kohore dhe standardet e vendosura;
- Siguroni sugjerime për përmirësime të vazhdueshme bazuar në analizat dhe të dhënat e përdorimit të databazave;
- Përgatitni raporte të rregullta për performancën dhe funksionalitetin e databazave, duke i





dorëzuar në kohë Autoritetit Kontraktor.

## Loti 2: Mirëmbajtja e Faqes së Internetit dhe Databazave

- Monitoroni faqen e internetit të projektit për të siguruar që ajo të jetë aktive dhe funksionale në çdo kohë;
- Gjurmoni dhe analizoni proceset e gjenerimit të përmbajtjes dhe publikimit, duke bërë rekomandime për optimizim;
- Kryeni analiza të detajuara mbi përdorimin e faqes, përfshirë rishikimin e statistikave të përdorimit dhe komentet e përdoruesve;
- Jepni informacion të rregullt për Autoritetin Kontraktor mbi gjetjet nga monitorimi dhe sugjerimet për përmirësime;
- Rekomandoni dhe zbatoni përmirësime në funksionalitetin e faqes bazuar në të dhënat e monitorimit dhe analizave të kryera.

Raporti dorëzohet jo më vonë se dy javë pas ekzekutimit të “Urdhëresës së Shërbimit”. Ai i dorëzohet kordinatorit/es së projektit. Pas ekzekutimit të “Urdhëresës së Shërbimit”, kontraktori do t'i sjellë Autoritetit Kontraktor faturën që korrespondon me detyrat e kërkuara si pjesë e Urdhrit të Shërbimit. Kordinatori i projektit është përgjegjës për miratimin e raporteve.

Raporti përbëhet nga një seksion narrativ dhe një seksion financiar. Seksioni financiar duhet të përmbajë detaje të shërbimeve të ofruara, në veçanti datat dhe çmimet aktuale sipas kontratës dhe/ose "Urdhëresës së Shërbimit"



## 7.1 Bugjeti:

A	B	C	D	E
Artikulli	Përshkrimi	Sasia/ muaj	Çmimi për njësi	Totali
1.1	<b>Përmbajtja migruese e faqes në internet</b> <b>Krijimi i përmbajtjes</b> <b>Zhvillimi i pjesës së re</b> <b>Mirëmbajtja e vazhdueshme e faqes në internet</b> <b>Redaktime, përditësime, detyra të dizajnit grafik</b> <b>Rezervime ditore, parandaloni hakerimin, të dhënat statistikore</b> <b>Sipas 4.1.2 të ToR</b>	<b>8 muaj</b>		
1.2	<b>Zhvillimi i Databazave ProfilPASS /</b> <b>3 versione në 3 gjuhë</b> <b>Sipas 4.1.2 të ToR</b>	<b>1</b>		
<b>Totali:</b> _____				